



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI
VENDIM

Nr. 142, Datë 16.07.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1 gërma “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1318/2 prot., datë 10.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

Konstatohet se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3820/3 prot., datë 18.06.2024, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1: çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, Shtojca 1, gërmat “b” dhe “c” si dhe nenin 16, pika 7, por në kuadër të një dosje të plotë aplikimi, shoqëria duhet të informojë në lidhje me sa më poshtë:

Neni 16 Rinovimi i licencës

- **gërma “a”**. **Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1. plotësuar pjesërisht**
- **gërma “c”** (deklarata e aplikuesit) Aplikuesi ka depozituar shtojcën 1 me dokumentacionin e kërkuar nga gërmat “a” dhe “b”, konstatojmë se aplikuesi nuk ka plotësuar gërmën “c”, pra deklaratën e aplikuesit. Si e tillë kjo pikë e rregullores konsiderohet e pa plotësuar dhe do t’i kërkohej aplikuesit të depozitohet edhe shtojcën 1/c.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 21.12.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI